

VENDIM
Nr.73, datë 5.2.2021

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR ORGANIZIMIN E
ZGJEDHJEVE PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

(Ndryshuar me VKM nr. 135, datë 5.3.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi prej 1 457 000 000 (një miliard e katërqind e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekësh, për organizimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021, i cili detajohet, si më poshtë vijon:

a) 931 000 000 (nëntëqind e tridhjetë e një milionë) lekë në zërin “shpenzime korrente”.
b) 526 000 000 (pesëqind e njëzet e gjashtë milionë) lekë në zërin “shpenzime kapitale me financim të brendshëm”.

2. Efekti financiar, i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, përballohet:

a) Në masën 1 000 000 000 (një miliard) lekë, nga fondi rezervë për zgjedhjet, miratuar për vitin 2021;
b) Në masën 457 000 000 (katërqind e pesëdhjetë e shtatë milionë) lekë, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për raste të paparashikuara të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama